



Ne baze te nenit 12, paragrafi 2, shkronja (c), të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", neneve 15, 29, pika 2 te Statutit te Komunës se Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, nenit 5 lidhur me nenin 7, pika 3, te Ligjit Nr-04/L-144, për dhënien ne shfrytëzim dhe këmbimin e pronës se paluajtshme te Komunës, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-35/2012", nenit 4, lidhur me nenin 5, të Rregullores QRK, Nr-23/2013, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datë, 26.09.2018 miratoi këtë:

## V E N D I M

### Neni 1

**1.1 JEPET PËLQIMI-** për të zhvilluar procedurat e ankandit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër deri në 10, (dhjetë) vite të pronës së paluajtshme të Komunës parcela si më poshtë:

**1.2 Parcela,** kadastrale, me numër **P-72116046-02784-1**, sipas certifikatës Nr.952-2/2018-3196, të datës 09.08.2018 me sipërfaqe prej; **109592m<sup>2</sup>** vendi i quajtur "**Gradina/Straqinoga**", zona kadastrale Suharekë, me destinim tokë ndërtimore, pasurisë shoqërore në emër të Kuvendit Komunal e Suharekë, nga sipërfaqja e përgjithshme prej; **200m<sup>2</sup>** ndahen për ndërtimin e lokalit afarist të karakterit të përkohshëm.

### Neni 2

**OBLIGOHET-**Drejtoria për shërbime pronësore juridike dhe kadastrë dhe zyra e prokurimit që në bashkëpunim me komisioni për zbatimin procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës se paluajtshme të Komunës, afatshkurtër dhe afatgjatë, që të zhvilloj procedurat e ankandit publik, konform dispozitave të Ligjit Nr-04/L-144, për dhënien ne shfrytëzim dhe këmbimin e pronës se paluajtshme te Komunës, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-35/2012" dhe të Rregullores (QRK) Nr-23/2013, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës.

### Neni 3

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr- 28/2008", nenit 8, të Rregullores, Nr-01/2016 për shqyrtimin administrativ te akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare te Komunës.

## KUVENDI I KOMUNËS-SUHAREKË

01-Nr-104-62562  
Më datë 27-09-2018

Kryesuesi i Kuvendit  
  
Bexhet KUÇI